



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 5 Maj 2023

Nr: 440

Ora: 12:30

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT NR. 336 ID TË ORGANIZATËS “QENDRESA QYTETARE”, NDAJ KRYETARIT TË BASHKISË KUKËS, DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS, DREJTORIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE “SHABAN MURATI” KUKËS DHE PERSONIT PËRGJEGJËS PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË ZGJEDHJEVE VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 5 Maj 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim denoncimin që u përket:

**KËRKUES:** Qendra “Qëndresa Qytetare”

**SUBJEKT:** Z. Safet Gjici, Kryetar dhe kandidat për bashkinë Kukës  
Zj. Dallëndyshe Bici, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës  
Z. Rustem Dervishi, Drejtori i Shkollës 9-Vjeçare “Shaban Murati” Kukës  
Z. Dëfrim Korbi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kukës

**OBJEKTI:** Shqyrtim administrativ për shkelje administrative në kundërshtim me parashikimet e neneve 91 dhe 92, të Kodit Zgjedhor

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 dhe 171, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

Data: 05 Maj 2023

Nr: 440  
Ora: 12:30



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 336 ID të Qendres  
“Qëndresa Qytetare”

## KONSTATOJ:

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur denoncimi me nr. 336 ID nëpërmjet shkresës së datës 17.04.2023, administruar me tonën me nr. 3964/1 prot., datë 19.4.2023, me denoncues Qendra "Qëndresa Qytetare". Pala denoncuese pretendon se ka patur përdorim të burimeve publike nga ana e zj. Dallëndyshe Bici, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (*këtu dhe në vijim ASHK*), z. Safet Gjici kryetari aktual i bashkisë Kukës dhe kandidat për zgjedhjet e datës 14 Maj 2023, i propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë dhe z. Dëfrim Korbi person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike për bashkinë Kukës.

Në denoncimin regjistruar nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me nr. **336 ID**, pretendohet se: *"Më datë 16 prill 2023, në ambientet e jashtme të shkollës 9-vjeçare, Lusën, Ujmisht, është zhvilluar një takim mes kandidatit të Partisë Socialiste për Bashkinë e Kukësit, njëherazi dhe kryetar aktual i kësaj Bashkie, z. Safet Gjici dhe banorëve të fshatit. Siç rezulton nga pamjet filmike, z. Gjici ka qenë i shoqëruar nga znj. Dallëndyshe Bici, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Në ndërfaqen e raportimeve, nuk rezulton që aktiviteti në fjalë të jetë raportuar nga bashkia e Kukësit. Po ashtu, aktiviteti nuk rezulton të jetë raportuar as nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. Gjatë këtij takimi, ndër të tjera, Dallëndyshe Bici, fjala e së cilës pasqyrohet në minutat 0:56-:2.10, të videos, të publikuar, shprehet: "Jam këtu me bekimin e Kryeministrit për të qenë në krah të kandidaturës më të mirë për Kukësin. Duke qenë drejtoreshë për shumë vite në qeverinë shqiptare më është dhënë mundësia për të punuar edhe me kryetarë bashkie të djathtë, por me kryetar Safetin nuk më ka pushuar telefoni për hallet tuaja, për hallet e gjithësecilit." Në vijim, ajo shprehet se: "Nuk mund të kishte kandidaturë më të mirë për Kukësin sesa Safet Gjici. Të gjithë së bashku të kemi Z. Safet Gjicin të drejtojë bashkinë e Kukësit. Kjo është e mira e Kukësit, kjo është e mira juaj".*

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator dhe nenit 82 e vijues të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, "Për kundravajtjet administrative", kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të

organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Në vijim të procedurës administrative, fillova hetimin administrativ, duke kërkuar informacion në lidhje me veprimtaritë publike në kundërshtim me parashikimet e Kodit Zgjedhor dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

Denoncuesi pretendon se nëpërmjet kryerjes së aktiviteteve të mësipërm janë përdorur burime publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore, referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020.

Nëpërmjet adresës elektronike, palëve të denoncuara në këtë proces i është kërkuar informacion në datë 20.4.2023 në lidhje me denoncimin e administruar.

Më datë 23.4.2023, **bashkia Kukës** bën me dije se “Aktiviteti i publikuar në ndërfaqen e kryetarit/kandidatit, është aktivitet politik i organizuar nga subjekti partiak, në të cilën kandidon kandidati. Kryetari/kandidati në këtë rast ka ndjekur agjenden e tij si kandidat dhe figurë politike. Si e tillë kjo agjendë nuk përfshihet në raportimet e aktivitetit të bashkisë (nuk janë aktivitete të organizuara nga Bashkia Kukës), sipas Kodit Zgjedhor.

*Theksojmë se: subjekti partiak është oragnizatori i takimeve që kryetari/kandidati merr pjesë si figurë politike dhe ndjek agjendën që subjekti organizon.”*

Po ashtu **Agjencia Shtetërore e Kadastrës** me shkresën nr. 8278 prot., datë 26.4.2023, informon se “...në lidhje me pretendimin e organizatës “Qëndresa Qytetare”, mbi mos raportimin takimeve, që janë zhvilluar me datë 16 Prill 2023 mes kandidatit të Partisë Socialiste për bashkinë e Kukësit, njëherazi dhe kryetar aktual i kësaj bashkie, z. Safet Gjici dhe banorëve të fshatrave Ujmisht dhe Fshat, të Njesisë Administrative Grykë-Çajë, bashkia Kukës. Sqarojmë se sipas pikës 2, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Qendror Zgjedhor se një veprimtari është publike kur ajo pasqyrohet sipas rastit në radio, në televizion, në shtyp, në faqe interneti, në median online, në rrjetet sociale, ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër që mundëson publikun e gjerë të njihet, apo informohet mbi atë veprimtari. Në rastin konkret nga institucioni ynë nuk është organizuar asnjë veprimtari publike. Pasi prezenca zj. Dallëndyshe Bici, në këtë takim nuk lidhet me detyrën e saj funksionale si Drejtor i Përqijthshëm i Agjencisë Shtetore të Kadastrës, por si një vizitë e saj pranë miqve dhe familjarëve në vendin e origjinës jashtë orarit zyrtar të punës, e cila ka përkuar me ditën e organizimit të këtij takimi. Për më tepër nuk është kryer asnjë shkelle pasi në këtë takim rastësor nuk është bërë shpërndarje apo premtim publik për leje legalizimi apo çdo lloj titulli pronësie. Parashikuar sipas nenit 11 Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 i Komisionit Qendror Zgjedhor. Në këto kushte arsyetojmë se denoncimit të organizatës “Qendresa Qytetare” i është bërë në interpretim të qabuar të liqjit.”

Në vijim po ashtu më datë 27.4.2023, **Zyra Vendore Arsimore Kukës** ka bërë me dije se lidhur me denoncimin nr. **336 ID** bën me dije se “Bazuar në ankesën e paraqitur pranë jush në lidhje me takimin e zhvilluar në ambientet e shkollës 9-vjeçare “Shaban Murati, Lusen”, Zyra e Arsimit Parauniversitar Kukës, nuk është në dijeni të zhvillimit të këtij takimi. Pas komunikimit me drejtorin e shkollës, ai na

*komunikoi se nuk ka dijeni për zhvillimin e këtij takimi, dhe pranë kësaj shkolle nuk është zhvilluar asnjë takim politik.*

Në vijim të hetimit administrativ u zhvillua seanca dëgjimore e datës 26.4.2023, ora 12:00, ku u ftuan palët në proces duke u dhënë të drejtën për t'u shprehur dhe dhënë shpjegime në lidhje me çështjet objekt shqyrtimi.

Të pranishëm në këtë seancë ishin përfaqësuesi i autorizuar i Qendrës “Qëndresa Qytetare” z. Dhimitër Zguro dhe përfaqësuesi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës zj. Ledia Lila, ndërsa nuk u paraqit asnjë përfaqësues nga bashkia Kukës.

Në seancën publike, përfaqësuesi i Qendrës “Qëndresa Qytetare” konfirmoi edhe një herë pretendimet e paraqitura nëpërmjet denoncimit me nr. 336 ID të depozituara pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke theksuar edhe një herë se janë vënë në dispozicion të kandidatit, burime publike për qëllime zgjedhore. Gjithashtu pretenduan se zj. Dallëndyshe Bici, ka bërë thirrje elektorale për mbështetje për kandidatin e bashkisë Kukës, në zgjedhjet vendore që do të mbahen më datë 14 Maj 2023.

Nga ana tjetër përfaqësuesi ligjor i ASHK-së, zj. Lila, konfirmoi edhe një herë qëndrimin e institucionit dhe deklaroi se Agjencia Shtetërore e Kadastrës nuk është organizatore e asnjë veprimtarie publike objekt i denoncimit në fjalë. Prezenca e zj. Dallëndyshe Bici nuk lidhet me detyrat e saj funksionale si Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, por vizita e saj ishte një vizitë pranë miqve dhe familjarëve në vendin e origjinës jashtë orarit zyrtar të punë.

Pasi u dëgjuan palët në proces, ju kërkua të parashtrojnë konkluzionet përfundimtare, në përfundim të seancës dëgjimore z. Zguro, i qëndroi prapësimeve të paraqitura më parë dhe kërkoi: *konstatimin e shkeljeve dhe vendosjen e sanksioneve bazuar në nenin 172, të Kodit Zgjedhor.* Zj. Lila në përfundim të seancës dëgjimore i qëndroi pretendimeve të saj duke deklaruar se: *denoncimi është bërë duke e interpretuar në interpretim të gabuar të ligjit, pasi në këtë takim nuk janë bërë premtime për leje legalizimi apo për çdo lloj tituli pronësie.*

Në përfundim të hetimit administrativ si dhe verifikimit të rrethanave dhe fakteve:

- provohet se veprimtaria me karakter elektorale është kryer në ambientet e jashtme të institucioneve publike, konkretisht në ambientet e oborrit të shkollës 9-vjeçare “Shaban Murati”;
- vërtetohet se në këtë takim ka patur deklarime, thënie elektorale dhe thirrje për mbështetje të kandidatit për kryetar bashkie;
- provohet se kryetari i bashkisë Kukës, njëkohësisht kandidat për kryetar në bashkinë Kukës, me zhvillimin e fushatës elektroale në ambientet e shkollës 9-vjeçare “Shaban

Murati” konstatohet se ka përdorur burime publike në mbështetje të fushatës së tij zgjedhore.

- nuk provohet se pjesëmarrja e z. Dallendyshe Bici, të jetë në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, pasi takimet e zhvilluara nuk provohet të kenë patur lidhje me detyrat funksionale dhe institucionale.

Në mbështetje të nenit 92, të Kodit Zgjedhor i cili parashikon se *“Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”*, veprimtaritë e kryera në ambientet e shkollave 9-vjeçare, janë veprimtari me karakter publik pasi ka pasur pjesëmarrje të publikut. Nga materialet e dosjes hetimore, rezultoi se aktivitetet e kryera në datën 16.4.2023, me pjesëmarrjen e banorëve të zonës dhe me folës kryesor, kryetarin/kandidatin e bashkisë Kukës dhe zj. Dallëndyshe Bici, nuk janë raportuar në ndërfaqen e KQZ-së. Kodi Zgjedhor dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator parashikojnë detyrimin për raportim vetëm të institucionve publike për veprimtaritë me karakter publik.

Në këtë aspekt, vlerësoj të rëndësishme të sqarojë se, bashkia Kukës nuk ka pasur detyrimin për raportim të këtyre aktiviteteve, pasi në këtë rast kemi të bëjmë me takime politike/elektorale dhe jo aktivitete të institucionit publik.

Referuar veprimtarisë të mësipërme objekt denoncimi, rezultoi e provuar se veprimtaritë me karakter elektorale janë kryer në ambientet e shkollës 9-vjeçare “Shaban Murati”, Lusen, Ujmisht, ambiente të cilat nuk kanë rrethim, por i përkasin oborrit të institucionit. Gjithashtu rezultoi e vërtetuar se në këto takime ka patur deklarime, thënie elektorale dhe thirrje për mbështetje të kandidatit për kryetar bashkie.

Neni 91, pika 1, e Kodit Zgjedhor parashikon se *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia.”* Komisioni Rregullator, në vendimin nr. 9 në nenin 3, pika 1.3/c, qartësisht ka përcaktuar se *“veprimtari të ndaluara”, janë edhe ato veprimtari që përfshijnë: “vënien në dispozicion të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të parashikuara në nenin 142, të ligjit 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, për qëllime zgjedhore, që janë në pronësi apo administrim të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose të njësive të vetëqeverisjes vendore, apo enteve publike në nivel qendror ose të njësive të vetëqeverisjes vendore, apo çdolloj enti tjetër ku shteti zotëron kapital/kuota/aksione ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit”.*

Rezultoi e provuar gjithashtu se kryetari i bashkisë Kukës, njëkohësisht kandidat për kryetar në bashkinë Kukës, me zhvillimin e fushatës elektorale në ambientet e shkollës 9-vjeçare Lusën konstatohet se **ka përdorur burime publike** në mbështetje të fushatës së tij zgjedhore.

Nga hetimi administrativ i kryer dhe nga provat materiale të administruara në dosjen hetimore administrative, vlerësoj se jemi në kundërshtim me nenin 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor, për drejtorin e shkollës 9-vjeçare “Shaban Murati” z. Rustem Dervishi, pasi veprimtaria elektorale është kryer në ambientet e oborrit të shkollës.

Referuar pjesëmarrjes së zj. Bici në këto aktivitete nuk rezultoi e provuar pjesëmarrja e saj në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës pasi takimet e zhvilluara nuk provohet të kenë patur lidhje me detyrat funksionale dhe institucionale. Po ashtu nuk rezultoi e provuar se thëniet në këto aktivitete përbëjnë një bazë të mjaftueshme për të vërtetuar lidhjen e pjesëmarrjes në takime me cilësinë e postit që zj. Bici mban pranë ASHK. Thëniet në këto takime kanë patur karakter të përgjithshëm dhe jo institucional. Çdo person, pavarësisht postit që mban, si funksionar i partisë ku aderon, mund të jetë pjesëmarrës në aktivitete dhe të shprehë mendimet e veta, apo preferencat politike, gjithmonë pas orarit zyrtar të punës dhe jashtë mjediseve të institucioneve shtetërore. Vihet re se ky takim është zhvilluar ditën e dielë, datë 16.4.2023. Për rrjedhojë për zj. Dallëndyshe Bici vlerësohet se nuk jemi përpara shkeljeve të parashikimeve ligjore në fuqi dhe se duhet të pushohet shqyrtimi administrativ.

Për sa më sipër, referuar nenit 171, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar ku parashikohet se *“shkelja e dispozitave të Kodit Zgjedhor nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë”*, vlerësoj se z. Safet Gjici gjendet në shkelje të nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor dhe pikës 2, të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Referuar pikës 2, të nenit 171, të Kodit Zgjedhor, ku parashikohet se, *“Shkeljet e tjera të dispozitave të këtij Kodi, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 1,000 deri në 2,500 lekë”*, pasi u vlerësua në mënyrë të hollësishme veçmas çdo provë dhe të gjitha provat së bashku, të paraqitura nga administrata gjatë hetimit administrativ, vlerësoj se drejtori i shkollës 9-vjeçare “Shaban Murati”, z. Rustem Dervishi është në shkelje të nenit 91, pika 1, të Kodit Zgjedhor dhe pikës 2, të nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

#### PËR KËTO ARSYE:

Data: 5 Maj 2023

Nr: 440

Ora: 12:30



“Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve nr. 336 ID të Qendresë  
“Qëndresa Qytetare”

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, 91, 92 ,171, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 dhe vendimin nr. 9, datë 09.03.2021 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

#### **V E N D O S :**

1. T’i propozojë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve marrjen e masës administrative për:
  - a) z. Safet Gjici, Kryetar dhe njëkohësisht kandidatit për bashkinë Kukës në vlerën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
  - b) z. Rustem Dervishi, Drejtor i Shkollës 9- Vjeçare “Shaban Murati” në vlerën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë.
2. Pushimin e hetimit administrativ dhe moskonstatimin e shkeljes ndaj:
  - a) zj. Dallëndyshe Bici, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
  - b) z. Dëfrim Korbi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kukës.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**